



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE"
SH.A. SUHAREKË

Në bazë të dispozitave të nenit 20,tëLigjit Nr-04/L-111,për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087,për ndërmarrje publike("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës",Nr-13/2012),të nenit 9,tëLigjit ,Nr-04/L-012,mbi mbrojtjen nga zjarri,("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr-7/2011),Bordi i Drejtorëve i "Stacioni i Autobusave "SH.A në Suharekë, më _____,miraton këtë:

RREGULLORE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

I.DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

1.Qëllimi

Neni 1.

Në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit ,Nr-04/L-012,mbi mbrojtjen nga zjarri,(“ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”,Nr-7/2011),për ndërmarrje publike lokale“Stacioni i Autobusave “SH.A në Suharekë,me qëllim të mbrojtjes së të punësuarve dhe të pasurisë së saj nga zjarri si dhe pengimit,parandalimit dhe evitimit të rrezikut nga pasojat që mund të shkaktojë zjarri përcakton:

- 1. Masat mbrojtëse nga zjarri.**
- 2. Organizimin e mbrojtjesë nga zjarri,**

3. Të drejtat dhe obligimet e të punësuarve lidhur me zbatimin e masave parandaluese për mbrojtjen nga zjarri,
4. Përgjegjësia e tyre në rast të mosrespektimit të masave parandaluese dhe detyrave në rast të shpërthimit të zjarrit si dhe pjesëmarrjen në shuarjen e tyre,
5. Mënyren e trajnimit, paisjet teknike dhe mjetet për shuarjen e zjarrit si dhe ndërmarrjen e veprimeve adekuate për shuarjen e tij në rast shpërthimi.

Neni 2.

Mbrojtja nga zjarri përfshinë tërësinë e masave dhe ndërmarrjen e veprimeve konform akteve normative të ndërmarrjes me qëllim parandalimit, pengimit, zgjerimit si dhe shuarjes së zjarrit nëse eventualisht shpërthen në objekt të ndërmarrjes.

Neni 3.

Mbrojtja nga zjarri organizohet dhe zbatohet në qdo kohë në të gjitha objektet e ndërmarrjes me seli në Suharekë dhe lokalet të cilat i kanë në shfrytëzim, në harmoni me aktet normative në fuqi, planit për reagim emergjent si dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje.

2. Përkufizimet

Neni 4.

Termet e përdorura në këtë Rregullore përcaktohen si vijojn:

“**Rregullore**”, Akt i karakterit të përgjithshëm më të cilen afërsisht përpunohen rregullat të caktuara të ligjit ose të dispozitës për zbatimin e saj.

“**Zjarri**”, është reaksion kimik i tre burimeve : lëndë djegëse, nxitësisë, dhe oksigjenit.

“**Mbrojtja nga zjarri**” nënkupton shpëtimin e njerëzve, të pasurisë dhe të mjedisit të rrezikuar nga zjarri dhe shpërthimet, ofrimin e ndihmës teknike në fatkeqësi dhe në situata të rrezikshme, zbatimin e masave parandaluese dhe kryerjen e detyrave tjera të përcaktuara me planin e mbrojtjes nga zjarri.

“**Parandalimi**” nënkupton tërësinë e masave dhe punëve , të cilat ndërmirren me parandalimin e shkakut të zjarrit apo për zvogëlimin e pasojave të zjarrit.

“**Prona**” nënkupton objekt, pjesët e objekteve dhe hapësirat , të cilat janë në pronësi në ndërmarrjen publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A në Suharekë.

“**Reagimi emergjent**”, nënkupton veprimet e kryera në rast fatkeqësie natyrore dhe fatkeqësive të tjera nga autoriteti qendror, komunal dhe nga shërbimet emergjente për zvogëlimin dhe lehtësimin e dëmeve të shkaktuara në njerëz, prone ose në mjedis.

“**Shërbimet emergjente**”, nënkuptojnë shërbimet e siguruar nga: FSK, Policia e Kosovës, shërbimet emergjente mjekësore spitalore dhe para spitalore të Kosovës, shërbimet komunale të zjarrfikëse dhe të shpëtimit dhe shërbimet mjekësore komunale dhe OJQ-të përkatëse.

Neni 5.

Me qëllim të evidentimit të shkaqeve të shpërthimit, të pengimit, të zgjerimit dhe shuarjsë së zjarrit, shpëtimit të punësuarve dhe pasurisë së rrezikuar nga zjarri në objektin e ndërmarrjes dhe locale ku ajo vepron duhet të ndërmerren masa adekuta për nga zjarri siq janë:

1. aplikimi i normave teknike në të gjitha objektet e ndërmarrjes sipas standarteve për mbajtjen nga zjarri apo adoptimi i tyre dhe rikonstruimi i objekteve ekzistuese me instalimin e paisjeve adekute;
2. pajisja e objekteve me hidrate si dhe paisjet me mjetet tkera për shuarjen e zjarrit të cilat janë paraparë me ligj;
3. vendosja e tyre në objek precizohet me planin për reagim emërgjent në ndërtesën ku vepron;
4. instalimet dhe paisjet elektrike ,të ventilimit,të ngrohjes,rrufepritësit,kanalizimit etj në ojektet e ndërmarrjes mund të vendosen në ato vende në mënyrë profesionale me qëllim që të mos paraqesin rrezik nga zjarri
5. personat e autorizuar janë të obliguar që të bëjnë kontrollin e gjendjes dhe të funksionim të drejtë të të gjitha paisjeve dhe investimeve më qëllim që të mos jenë shkaktare të zjarrit nëse eventualisht mund të dëmtohen;
6. në ojektet e ndërmarrjes ndalohet përdorimi i zjarrit të hapur, llambave ndriqese me gaz, mjeteve të tjera ndesëze me shkrepje, shfrytëzim i aparateve ngrohëse me sipërfaqe të skuqur-ndezur, mbajtja dhe vendosja e materialeve që lehtë ndezen. Me vendim të posaqëm caktohen vendet ku mund të pihet duhani, ndërsa në lokalet e tjera është e ndaluar pirja e duhanit.
7. është obligim për të gjithë të punësuarit në ndërmarrje që të q'kyqjone të gjitha aparateve termoteknike dhe paisjeve tjera pas mbarimit të orarit të punës;
8. hyrja –dalja ,kalimet dhe shkallët në objektet e ndërmarrjes duhet të jenë gjithmonë të lira për kalim;
9. në ojektet e ndërmarrjes ndalohet kryerja e veprimeve –punëve që mund të jenë nxitëse të zjarrit ,ato mund të kryhen me leje të veqant të Kryeshefit,pasi që më pare të jenë marrë të gjitha masat për mbrojtjet nga zjarri.

Neni 6.

Aparatet ,paisjet dhe mjetet e dedikuara për shuarjen e zjarrit si dhe paisjet dhe instalimet për lajmërim dhe sinjalizim automatik të zjarrit në objektet e ndërmarrjes publike locale”Stacioni i Autobusëve”SH.A në Suharekë,mund të përdoren vetëm atëherë kur të i përmbushin kriteret e parapara me ligj dhe standartet teknike ose pas marrjes së atestit nga institucioni i autorizuar.

- 1.aparatet ,paisjet dhe mjetet për shuarjen e zjarrit vendosen në vend të përshtatshëm ku qasja asht e lierne objektin e ndërmarrjes ato mund të përdoren dhe shfrytëzohen vetëm për shuarjen dhe lokalizimin e zjarrit;
- 2.vendet në të cilat ndodhën mjetet për shuarjen e zjarrit shënohen me shenja dalluese;
3. aparatet ,paisjet dhe mjetet për shuarjen e zjarrit si dhe paisjet për sinjalizimin e lajmërimit automatik të zjarrit mbahen në gjendje të rregullt dhe për to mbahen evidence;
- 4.përgjegjësi për vendosjen,mirëmbajtjen,rimbushjen dhe kontrollimin teknik të aparateve është përgjegjësi për siguri në ndërmarrje.

4.Organizimi i mbrojtjes nga zjarri

Neni 7.

Me qëllim të zbatimit të masave të parapara për mbrojtjen nga zjarri si dhe të aktivitetit dhe detyrave tjera të parapara me Ligjin për mbrojtjen nga zjarri dhe akteve tjera që rregullojnë këtë lëmi përcaktohet organizimi mbrojtjes nga zjarri në objektet e ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve"SH.A në Suharekë

Neni 8.

Aktivitetet e zbatimit të masave parandaluese të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësive tjera në ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobusëve"SH.A në Suharekë,i kryen zyrtari i sigurimit në bashkëpunim me personelin e ndërmarrjes i cili është i obliguar të plotësoj kriteret themelore për krijimin e marrëdhënies së punës siq janë:përgaditja adekuate shkollore e cila përcaktohet me aktin mbi sistemin e vendeve të punës në stacion,kryerjen e trajnimeve teorike dhe praktike nga kjo lëmi në institucionet shtetërore apo ato të cilat janë licencuar nga organet kompetente.

Neni 9.

Punëtorët të cilët kryejn detyrat e sigurimit janë të obliguar që:

- 1.gjatë orarit të punës në shërbim veq tjerash të kryejnë edhe punët e drejtpërdrejta të mbrojtjes nga zjarri në bazë të Ligjit ,kësaj Rregulloreje,akteve tjera normative të ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve"SH.A në Suharekë ;
- 2.gjatë kujdestarisë viziton objektin,të gjitha hapësirat,aparatet për fikje të zjarrit,paisjet tjera dhe instalimin e nëse vëren parregullsi lajmëron udhëheqësin e drejtpërdrejt dhe njëkohësisht ndërmerr masa për pengimin e pasojave të padëshiruara;
- 3.të njoftohet me masat e mbrojtjes nga zjarri të përcaktuar me këtë Rregulloreje dhe të parapara me palnin për reagim emergjent,të studion ato vazhdimisht me qëllim të zbatimit me më efikasitet në rast se ndodh ndonjë fatkeqësi;
- 4.të aftësohet nga fushëveprimi i mbrojtjes nga zjarri duke marr pjesë në trajnime të cilat i organizon organi kompetent në institucione profesionale nga kjo lëmi;
- 5.me rastin e pranimit të detyrës punëtori është i obliguar të jetë i aftë në aspektin psiko-fizikë për kryerjen e obligimeve gjatë orarit të punës;

6. obligohet që t'i ruaj, mirëmbaj dhe shfrytëzoj paisjet personale dhe të përbashkëta me të cilat është ngarkuar gjatë orarit të punës dhe zbatojë kodin e mirësjelljes;
7. është i obliguar që gjatë orarit të punës të ndërmerren të gjitha masat për mbrojtjen e objektit, të punësuarve dhe pasurisë së ndërmarrjes nga fatkeqësia e ndryshme eventuale

Neni 10.

Personi i autorizuar organizon dhe orienton punën e shërbimeve dhe bashkëpunon që të:

1. kujdeset për zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri të parapara me Ligj dhe aktet e tjera normative si dhe zbatimin e kësaj Rregulloreje në ndërmarrje ;
2. përcjell dhe studion dispozitat ligjore nga lëmi kundër zjarrit dhe ndërmerr masat e duhura për të harmonizuar punën e shërbimit me ato dispozita me qëllim të avancimit të mbrojtjes kundër zjarrit;
3. mbikëqyr gjendjen e mbrojtjes kundër zjarrit dhe të sigurisë së objekteve ,personelit dhe pasurisë në ndërmarrje dhe ndërmerr masa për evitimin e të metave dhe pengimin e pasojave të dëmshme ;
4. merr pjesë në përgaditjen e propozimeve të planeve në lëmin e mbrojtjes nga zjarri dhe pas aprovimit të tyre kujdeset për realizimin e tyre;
5. bashkëpunon me organet kompetente komunale dhe objektet tjera nga kjo lëmi.

Neni 11.

Kryeshefi ekzekutiv në lëmin e organizimit, zbatimit dhe avancimit të mbrojtjes nga zjarri veq detyrave që kanë kompetence të precizuara me aktet normative të ndërmarrjes është i obliguar që kryej edhe këto detyra :

1. të zbatoj me konsekuencë Rregullorën për mbrojtjen nga zjarri të aprovuara nga Bordi i drejtorëve i ndërmarrjes;
2. të zbatojë planin për trajnim për punëtorët e sigurimit në lëmin e mbrojtjes nga zjarri;
3. të kujdeset për sigurimin e paisjeve të nevojshme për mbrojtjen kundër zjarrit dhe dhe ndërmerr masa për mirëmbajtjen ,kontrollim teknik dhe masa tjera me qëllim të shtimit të shkallës së sigurisë në objektin e ndërmarrjes;
4. do të mbikëqyrë dhe është përgjegjëse për organizimin e mbrojtjes kundër zjarrit në objektin e ndërmarrjes;
5. në rastet kur konsiderohen të metat apo mangësitë është i obliguar që menjëherë të ndërmerren masa me qëllim të evitimit të parregullsive të vërejtura;
6. është i obliguar që me kohë të informojë punëtorët me obligimet e tyre ,me gjendjen,masat dhe mjetet që janë në dispozicion me qëllim të zbatimit dhe avancimit të mbrojtjes nga zjarri;

5. Të drejtat dhe obligimet e Bordit të Drejtorëve ,dhe të punësuarve lidhur me zbatimin e masave parandaluese për mbrojtjen nga zjarri

Neni 12.

Bordit i Drejtorëve përveq që aprovon Rregulloren për mbrojtjen nga zjarri ka edhe këto detyra:

1. është i obliguar të krijoj kushte për siguri në punë të punësuarve për mbrojtjen nga zjarri dhe faktorët që mund të shkaktojnë shpërthimin e zjarrit;
2. është i obliguar të krijoj një fond për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të domosdoshme për sigurimin e të gjitha paisjeve të mbrojtjes nga zjarri në harmoni me nenin 2, paragrafi 2.2 të Ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës.

Neni 13.

Kryeshefi ekzekutiv në fushën e mbrojtjes nga zjarri ka këto detyra:

1. realizon dhe mbikëqyr gjendjen e organizimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shkallën e sigurisë dhe në bazë të mjeteve që ka në dispozicion lejon shfrytëzimin e tyre;
2. aprovon planin për reagim emergjent në ndërmarrje;
3. përcakton përgjegjësinë e bashkëpunëtorëve me autorizim e përgjegjësi të posaqme, në rast të mos përmbajtjes së masave të parapara me Rregulloren si dhe akteve tjera normative të ndërmarrjes;
4. shqyrton raportet dhe vendimet e organeve kompetente shtetërore, propozon masa dhe aktivitete që dobësitë e vërejtura të evidëntohen me kohë;
5. informon Bordin e Drejtorëve të ndërmarrjes për të gjitha qështjet aktuale nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë të tjera.

Neni 14.

Përgjegjësitë në fushën e mbrojtjes nga zjarri ka këto detyrime për organizim të mbrojtjes nga zjarri:

1. është përgjegjësi për organizimin e procesit të punës, të kontrollojnë dhe sigurojnë aplikimin dhe përmbajtjen e masave të parapara për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera në ndërmarrjen për njesinë organizative në të cilën udhëheq dhe në rast se vëren të meta, ndërmarrin masa emergjente për evitimin e tyre;

2. të inicojë procedura disiplinore për të gjithë të punësuarit nëse nuk u përmbahet masave të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 15.

Me qëllim të realizimit të efikasitetit të detyrave për mbrojtje të punësuarve dhe pasurisë së ndërmarrjes nga zjarri dhe fatkeqësi të tjera, Kryeshefi ekzekutiv cakton person për zjarrfikjedhe shpëtimi i cili është përgjegjës për përcjelljen e gjendjes së organizimit të mbrojtjes nga zjarri dhe zbatimin e masave të parapara me këtë Rregullore.

6. Përgjegjësitë e punëtorëve që nuk i respektojnë masat parandaluese

Neni 16.

Të punësuarit në ndërmarrje janë të obliguar që gjatë orarit të punës t'u përmbahen masave të parapara për mbrojtjen nga zjarri të përcaktuar me këtë Rregullore, Ligjit për mbrojtje nga zjarri dhe akteve të tjera normative të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 17.

Moszbatimi i masave nga neni 14, i kësaj Rregulloreje paraqet shkelje të rendit të detyrave dhe disiplinës në punë në bazë Rregullore mbi përgjegjësinë disiplinore të ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A në Suharekë.

Neni 18.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme dhe aplikohen për të gjithë të punësuarit në ndërmarrje si dhe të gjitha të tjerëve të cilët në qfarëdo bazë punojnë ose kryejnë punë në ndërmarrje .

7. Mënyrat e trajnimit, paisjet teknike dhe mjetet për shuarjen e zjarrit si dhe ndërmarrjen e veprimeve adekuate për shuarjen e tij.

Neni 19.

1. Trajnimi i punëtorëve të sigurimit në ndërmarrje në lëmin e mbrojtjes nga zjarri bëhet ekskluzivisht në institucione shtetërore apo institucionet e licencuara nga organet kompetente shtetërore në bazë të programit të punës i cili aprovet nga Kryeshefi ekzekutiv apo nga personi i autorizuar nga ai.

2. Me program parashihet trajnimi për fitimin e njohurive më elementare teorike si dhe praktike, përmes ligjeratave, seminarëve dhe konsultimeve.

3. Bordi i Drejtorëve me plan të posaqem cakton format dhe mënyrat e trajnimit të punëtorëve të sigurimit varësisht nga mundësia organizative të realizimit të tyre.

Neni 20.

Për kryer me sukses të punëve për mbrojtje të punësuarve dhe pasurisë në ndërmarrje nga zjarri dhe shuarjën e tij në bazë të dispozitave ligjore për kategorizimin sipas rrezikshmërisë nga zjarri parashihet sigurimi i paisjeve dhe mjeteve tjera teknike. Për llojet, sasinë dhe tipin e paisjeve teknike për mbrojtjen nga zjarri bëhet plan konkret për secilin objekt të ndërmarrjes.

Neni 21.

Procedurat në rast të shpërthimit të zjarrit dhe detyrat e të punësuarve caktohen me Planin për reagim emergjent të ndërmarrjes.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 22.

Për të gjitha qështjet nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri të cilat nuk janë të cekura në këtë Rregullore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga zjarri dhe aktet e tjera që e rregullojnë këtë lëmi.

Neni 23.

Me përmbajtjen e kësaj Rregulloreje të njoftohen të gjithë të punësuarit në ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve “SH.A në Suharekë.

Neni 24.

Kjo rregullore mundë të ndryshohet me procedurë të njejtë me atë të miratimit nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusave” në Suharekë, me propozimet e arsyetuara me shkrim.

Neni 25.

Kjo rregullore hyn në fuqi 8,(tetë) ditë pas miratimit nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusave” SH.A në Suharekë, dhe pas shpalljesë publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusave”SH.A në Suharekë.

BORDI I DREJTORËVE

KRYESUESI I BORDIT TË DREJTORËVE

Nr. _____
Me datë 17.03.2014

Bexhet Kuqi